

THIRRJE PËR NOMINIME NGA OSHC-TË PËR PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE NË CILËSINË E VËZHguesVE TË PUNËS SË KOMISIONEVE PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESËVE TË SË DREJTËS NË BANIM PËR FAMILJET QË JANE RASTE SOCIALE, DHE KOMISIONIN PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESËVE TË SË DREJTËS NË BANIM PËR KATEGORITË E DALA NGA LUFTA E UÇK-së FAMILJEVE TË DËSHMORËVE, VETERANËVE, VIKTIMAVE TË DHUNËS SEKSUALE DHE PERSONAVE TJERË ME NEVOJA TË VECANTA NGA KËTO KATEGORI.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies sociale pas miratimit të Vendimit nr.02/78 I dt.09.03.2016, nga Qeveria e Republikën së Kosovës, me të cilin vendim ju është ndryshuar qëllimi i përdorimit të kompleksit banesor – afaristë “ Hade dhe Hade 2, është autorizuar MPMS të themeloj:

- Komisionin për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim, për familjet që janë raste sociale dhe:
- Komisionin për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim, për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, familjeve të dëshmorëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale dhe personave tjerë me nevoja të veçanta nga këto kategori,

Në këto dy komisione janë paraparë edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile në cilësinë e vëzhguesve. Me këtë rast kërkohen 2 përfaqësues të shoqërisë civile (një përfaqësues për një komision).

Kriteret për organizata që nominojnë përfaqësuesit e tyre:

Të drejtën për të nominuar kandidatë kanë të gjitha OShC-të e regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asociimit në OJQ si dhe rrjetet e OShC-ve (pavarësisht regjistrimit të tyre), të cilat:

1. Janë aktive për të paktën 3 vite;
2. Organizata të ketë mision së paku njërën nga këto fusha: Banimi Social, Të Dreja të njeriut, Persona me Nevoja të Veçanta, Dhuna në Familje, Mbështetje të personave viktimave të dhunës seksuale.

Ftesa nuk është e kufizuar vetëm te organizatat anëtare të Platformës CiviKos



Kriteret për personat që nominohen:

1. Të kenë përvojë të dëshmuar në fushën përkatëse për të paktën 3 vite;
2. Të jenë të angazhuar në një organizatë të shoqërisë civile e cila për të paktën 3 vite të fundit ka fushë të veçantë të veprimtarisë në fushat përkatëse
3. Të jenë persona me integritet të lartë, dhe
4. Mos të kenë konflikt interesi me kategoritë përfituese.

Për të nominuar një kandidat/e, OSHCja duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Një cv të kandidatit/es së nominuar
2. Letër motivimi (max. 1 faqe) si dëshmi për përvojën e tyre në OSHC dhe përvojën e kandidatit në fushat e mësipërme
3. Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së ose një dokument që dëshmon aktivitetin e rrjetit jo-formal.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen përmes email: info@civikos.net, ose në zyret e Platformës CiviKos Rr. Bedri Pejani 7/A 10000 Prishtinë.

Afati për dorëzimin e dokumenteve është data 08.05.2017 ora 16:00

Në rast të procedurave të votimit

Në rast se kemi më shumë se 1 kandidat që i plotësojnë kriteret atëherë do të shkohet me procedura të votimit, sipas Rregullores së Punës të CiviKos. Kandidati që merr më së shumti vota do të përzgjidhet si përfaqësues i Shoqërisë Civile.

Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos, një anëtar i Bordit të CiviKos dhe një përfaqësues i MPMS-së do të verifikojë nëse kandidatët e nominuar i plotësojnë kriteret e kërkuara. Të gjithë kandidatët që konstatohet që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përfshihen në listën përfundimtare për votim.

Menjëherë pas përpilimit të listës përfundimtare për votim, të gjitha OSHC-të e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 5 ditësh nga hapja e procesit të votimit. Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail, postë të rregullt ose personalisht në zyrën e CiviKos. Votuesit mund të votojnë në mënyrë anonime me hedhjen e votës së tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos-it. Në cilëndo mënyrë të votimit, fletëvotimit duhet t'i bashkëngjitet edhe kopja e certifikatës së regjistrimit të organizatës.



Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos. Pas zgjedhjeve, Komisioni shqyrton dhe numëron fletëvotimet dhe përcakton se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OShc-ve do të përcaktohet me short në mes tyre.

Për të reflektuar diversitetin shoqëror dhe të shoqërisë civile në Kosovë, inkurajohet nominimi i grave dhe vajzave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nënpërfaqësuar.